



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Tiranë më 18/11/2025

Nr. 7184

Lënda: Njoftim për vazhdimin e procedurave për dhënien e mandatit

Drejtuar: Këshillit të Bashkisë Tropojë ✓

Sheshi "Azem Hajdari", Qyteti Bajram Curri

Partisë Bindja Demokratike

Rruga "Elbasanit", Ndërtesa nr. 5, 1000 Tiranë

Z. Shyqyri Ram Hoxha

Lagjia Paqe, Tropojë

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, në seancën publike të datës 17.11.2025, mori në shqyrtim projekt-vendimin "Për plotësimin e vakancës në këshillin e bashkisë Tropojë, pas verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidatit, vendosi "Plotësimin e vakancës në këshillin e bashkisë Tropojë, me kandidatin nga lista shumemërore e "Partisë Bindja Demokratike" z. Shyqyri Ram Hoxha.


Bashkëlidhur do të gjeni vendimin nr. 1508, datë 17.11.2025.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

Sekretar i Përgjithshëm

(Në mungesë dhe me urdhër)

Jona JOSIFI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 17.11.2025

Nr: 1508

Ora: 14:00

VENDIM

PËR

**PLOTËSIMIN E VAKANCËS NË KËSHILLIN E BASHKISË TROPOJË, ME
KANDIDATIN NGA LISTA SHUMEMËRORE E "PARTISË BINDJA
DEMOKRATIKE", Z. SHYQYRI RAM HOXHA**

Në mbështetje të neneve 19, pikat 1, shkronja "n" e 2 dhe 164, pikat 2 dhe 4, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", Kreut V, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit, "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", pasi shqyrtova dokumentacionin përkatës,

VËREJ:

Me shkresën nr. 4444/2 prot., datë 01.10.2025, Këshilli i Bashkisë Tropojë ka njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për krijimin e vakancës nga këshilltari, z. Adem Bel Dushi, propozuar nga subjekti zgjedhor Partia Bindja Demokratike.

Referuar nenit 164, pika 2 të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, kandidati vijues nga lista shumëmeërore e "Partisë Bindja Demokratike", për Këshillin e Bashkisë Tropojë, të cilit i kalon mandati i këshilltarit, është kandidati me numër rendor 03, z. Shyqyri Ram Hoxha.

Me shkresën nr. 6721, prot., datë 24.10.2025, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i është drejtuar kandidatit për anëtar në Këshillin e Bashkisë Tropojë, z. Shyqyri Ram Hoxha, me kërkesë për plotësim dokumentacioni.

Në bazë të nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", vetëdeklarimi dhe verifikimi i kushteve të të dhënave në përputhje me këtë ligj, kryhet për çdo kandidat të listës shumëmeërore për zgjedhjet pararendëse, për këshillin bashkiak, të cilit i takon të marrë mandatin e këshilltarit për vendin vakant.


Kandidati për këshilltar, përcaktuar në bazë të listës shumëmeërore, të subjektit "Partia Bindja Demokratike" ka plotësuar e depozituar formularin e vetëdeklarimit, me numër KU-BD-

Data: 17.11.2025 Nr: 1508
Ora: 14:00



"Për plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Tropojë, me kandidatin nga lista shumëmeërore e "Partisë Bindja Demokratike", z. Shyqyri Ram Hoxha"

1



14799_1_unik, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, si organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin në funksionin publik, ku përfshihet dhe funksioni i këshilltarit të bashkisë.

Nga verifikimi i formularit të vetëdeklarimit të z. Shyqyri Ram Hoxha, rezulton se nuk ka deklaruar asnjë të dhënë që ka të bëjë me parashikimet për ndalime në ligjin nr. 138/2015.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në zbatim të ligjit nr. 138/2015 dhe Kreut V, pika 2, shkronja "b" dhe pika 3, shkronja "c", të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit me shkresën nr. 6813 prot., datë 29.10.2025, ka kërkuar informacion nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile dhe me shkresën nr. 6817 prot., datë 29.10.2025, ka kërkuar informacion nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve për z. Shyqyri Ram Hoxha.

Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, me shkresën nr. 3701/1 prot., datë 04.11.2025, ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve verifikimin e të dhënave për kandidatin për anëtar z. Shyqyri Ram Hoxha, ku konstatohet se kandidati nuk ka ndryshime në përbërësit e gjendjes civile.

Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, nëpërmjet komunikimit elektronik, ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e gjendjes gjyqësore për z. Shyqyri Ram Hoxha, ku konstatohet se kandidati rezulton i rehabilituar në bazë të nenit 69 të K. Penal.

Në mbështetje të pikës 2, të Kreut V, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit konstatohet se të dhënat e kandidatit për anëtar z. Shyqyri Ram Hoxha, në Këshillin e Bashkisë Tropojë, nuk përbëjnë kusht për moszgjedhjen e kandidatit në funksionin e këshilltarit.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 19, pikat 1, shkronja "n" e 2 dhe 164, pikat 2 dhe 4, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, nenin 11, të ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", Kreun V, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit, "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike",

V E N D O S:

1. Plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Tropojë, me kandidatin nga lista shumëmemërore e "Partisë Bindja Demokratike", z. Shyqyri Ram Hoxha.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

Data: 17.11.2025 Nr: 1508
Ora: 14:00



"Për plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Tropojë, me kandidatin nga lista shumëmemërore e "Partisë Bindja Demokratike", z. Shyqyri Ram Hoxha"